

## **Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Të Miturve, të cilëve u është hequr liria**

**Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113,  
datë 14 dhjetor 1990**

### ***I. Perspektivat themelore***

1. Sistemi i drejtësisë për të miturit duhet të mbrojë të drejtat dhe sigurinë e të miturve, si dhe mirëqënien e tyre fizike dhe mendore. Burgimi duhet përdorur si masë e fundit.
2. Të miturve, duhet t'u hiqet liria vetëm në përputhje me parimet dhe procedurat e përcaktuara në këto Rregulla dhe në Rregullat e Standardeve Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit). Heqja e lirisë një të mituri duhet të jetë një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër dhe duhet të kufizohet për raste të jashtëzakonshme. Kohëzgjatja e masës duhet përcaktuar nga një autoritet gjyqësor, pa përjashtuar mundësinë e lirimit të parakohshëm të tij ose të saj.
3. Këto Rregulla kanë për qëllim të vendosin standarde minimale të pranuar nga Kombet e Bashkuara për mbrojtjen e të miturve, të cilëve u është hequr liria në të gjitha format, në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe me qëllim që të neutralizojë efektet e dëmshme të të gjitha llojeve të ndalimit dhe për të inkurajuar integrimin në shoqëri.
4. Këto Rregulla duhen zbatuar në mënyrë të paanshme, pa asnjë lloj diskriminimi për shkak të racës, ngjyrës, seksit, moshës, gjuhës, besimit fetar, kombësisë, bindjes politike apo rasteve të tjera, besimeve apo praktikave kulturore, pronës, statusit të lindjes apo atij familjar, origjinës etnike apo shoqërore dhe aftësisë së kufizuar. Besimet fetare apo kulturore, praktikat dhe konceptet morale të të miturve duhen respektuar.
5. Këto Rregulla janë projektuar në mënyrë të tillë që të shërbejnë si standarde praktike referuese dhe për të inkurajuar e udhëzuar profesionistët që merren me menaxhimin e sistemit të drejtësisë për të mitur.
6. Këto Rregulla duhet t'u jepen të gatshme personelit të drejtësisë për të mitur në gjuhën e tyre amtare. Të miturit që nuk e zotërojnë gjuhën e folur nga personeli i mjediseve të paraburgimit duhet të kenë të drejtën e shërbimeve falas të një përkthyesi kurdoherë që të jetë e nevojshme, në veçanti gjatë ekzaminimeve mjekësore dhe proceseve disiplinore.
7. Aty ku është e nevojshme, Shtetet duhet t'i përfshijnë këto Rregulla në legjisllacionin e tyre ose ta ndryshojnë atë si duhet dhe të sigurojnë kompensimin e duhur për shkeljen e tyre, përfshirë kompensimin kur dëmtimet bien mbi të miturit. Gjithashtu, Shtetet duhet të monitorojnë zbatimin e këtyre Rregullave.
8. Autoritetet kompetente duhet të përpiqen vazhdimisht të rrisin ndërgjegjësimin e publikut se kujdesi për të miturit e ndaluar, dhe përgatitja për kthimin e tyre në

shoqëri është një shërbim shoqëror me rëndësi të madhe, dhe për këtë qëllim duhet të ndërmerren hapa aktivë për të nxitur kontaktet e hapura midis të miturve dhe komunitetit vendas.

9. Asgjë në këto Rregulla nuk duhet interpretuar si diçka që përjashton zbatimin e instrumenteve dhe standardeve të Kombeve të Bashkuara dhe të të drejtave të njeriut, të njohura nga komuniteti ndërkombëtar, që ndikojnë për sigurimin e të drejtave, kujdesit dhe mbrojtjen e të miturve, fëmijëve dhe gjithë personave të rinj në moshë.

10. Në rast se zbatimi praktik i Rregullave të veçanta të përfshira në seksionet II deri në V, përfshirë, paraqet ndonjë konflikt me Rregullat që përmban ky seksion, përputhja me këto të fundit do të konsiderohet si kërkesa mbizotëruese.

## ***II. Qëllimi dhe Zbatimi i Rregullave***

11. Në zbatim të këtyre Rregullave, duhet të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

(a) I mitur është çdo person nën moshën 18 vjeç. Kufiri i moshës, nën të cilin nuk duhet lejuar heqja e lirisë një fëmije, duhet përcaktuar me ligj;

(b) Heqje lirie do të thotë çdo lloj ndalimi ose burgimi apo vendosja e një personi në një institucion publik ose privat, nga i cili ky person nuk lejohet të largohet me dëshirën e tij, me urdhër të ndonjë autoriteti gjyqësor, administrativ apo ndonjë autoriteti tjetër publik.

12. Heqja e lirisë duhet të bëhet në kushte dhe rrethana që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut të të miturve. Të miturve që qëndrojnë në ambiente paraburgimi u duhet garantuar përfitimi i aktiviteteve dhe programeve kuptimplote, që do të shërbenin për të nxitur dhe ruajtur shëndetin dhe vetërespektin e tyre, për të nxitur ndjenjën e tyre të përgjegjësisë dhe për të inkurajuar ato qëndrime dhe aftësi, që do t'i ndihmonin ata në zhvillimin e potencialit të tyre si anëtarë të shoqërisë.

13. Të miturve, të cilëve u është hequr liria, nuk do t'u mohohen, për asnjë arsye që lidhet me statusin e tyre, të drejtat civile, ekonomike, politike, sociale apo kulturore, të cilat ata i gëzojnë me ligj vendas apo ndërkombëtar dhe që janë të pajtueshme me heqjen e lirisë.

14. Mbrojtja e të drejtave individuale të të miturve përsa i përket sidomos ligjshmërisë së zbatimit të masave të ndalimit sigurohet nga autoriteti kompetent, ndërsa objektivat e integritetit shoqëror duhet të sigurohen nga kontrollet sistematike dhe mjete të tjera kontrolli, sipas standardeve ndërkombëtare, ligjeve dhe rregulloreve vendase, nga një organ i autorizuar për të vizituar të miturit dhe që nuk i përket mjedisit të paraburgimit.

15. Rregullat janë të zbatueshme për të gjitha llojet e mjediseve të paraburgimit, në të cilat të miturve u hiqet liria. Seksionet I, II, IV, dhe V të këtyre Rregullave janë të zbatueshme për të gjitha ambientet e paraburgimit dhe institucioneve, në të cilat mbahen të miturit, dhe seksioni III është i zbatueshëm në mënyrë të veçantë për të miturit nën arrest ose në pritje të gjyqimit.

16. Këto Rregulla zbatohen në kontekstin e kushteve ekonomike, shoqërore dhe kulturore që mbizotërojnë në secilin Shtet Anëtar.

### ***III. Të miturit nën Arrest ose në pritje të Gjyqimit***

17. Të miturit që mbahen të ndaluar nën arrest apo që presin gjykimin prezumohen të pafajshëm dhe trajtohen si të tillë. Arrestimi/ndalimi para gjyqit shmanget aq sa është e mundur dhe kufizohet në rrethana të jashtëzakonshme. Prandaj, bëhen të gjitha përpjekjet për të zbatuar masa alternative. Megjithatë, kur përdoret ndalimi parandalues, gjykatat e të miturve dhe organet hetuese i japin përparësi më të madhe procedimit të përsheptuar të këtyre rasteve për të siguruar kohëzgjatjen më të shkurtër të mundshme të paraburgimit. Të ndaluarit, që nuk kanë dala akoma para gjyqit, duhet të veçohen nga të miturit që kanë marrë dënimin.

18. Kushtet, në të cilat ndalohet një i mitur, duhet të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuar më poshtë, me dispozita të veçanta kur është e nevojshme apo e duhur, duke pasur parasysh kërkesat e prezumimit të pafajësisë, kohëzgjatjen e ndalimit/detention, statusin ligjor dhe rrethanat e të miturit. Këto dispozita do të përfshinin, po jo domosdoshmërisht kufizoheshin në:

(a) Të miturit duhet të kenë të drejtën e këshillimit ligjor dhe u krijohet mundësia për të kërkuar ndihmë ligjore falas, aty ku një ndihmë e tillë është e disponueshme, si dhe të komunikimit sistematik me këshilltarët e tyre ligjorë. Jeta private dhe konfidencialiteti duhet të garantohen për një komunikim të tillë;

(b) Të miturve duhet t'u sigurohen, aty ku është e mundur, mundësitë për të punuar, me shpërblim, dhe për të vazhduar shkollën ose trajnimin, por nuk u duhet vënë kusht që ta bëjnë një gjë të tillë. Puna, arsimi apo trajnimi nuk duhet të bëhen shkak për vazhdimin e ndalimit;

(c) Të miturve duhet t'u jepen dhe të kenë mundësi të ruajnë materiale për kohën e tyre të lirë në përputhje me interesat e vënies të drejtësisë.

### ***IV. Menaxhimi i Mjediseve për të Mitur***

#### ***A. Të dhënat e gjendjes gjyqësore***

19. Të gjithë raportet, përfshirë të dhënat ligjore, të dhënat mjekësore dhe ato të proceseve disiplinore, si dhe të gjitha dokumentet e tjera që kanë lidhje me formën, përmbajtjen apo hollësi të trajtimit, duhen vendosur në dosje individuale konfidenciale, të cilat duhet të rifreskohen, të mund të shihen vetëm nga persona të autorizuar dhe të klasifikohen në mënyrë të tillë që të kuptohen me lehtësi. Kurdo që është e mundur, çdo i mitur duhet të ketë të drejtë të kontestojë çdo fakt apo opinion, që përmban dosja e tij ose e saj në mënyrë që të lejohet korigjimi i deklarimeve të pasakta, të pabazuara apo të padrejta. Për ta ushtruar këtë të drejtë, duhet të ekzistojnë procedura, që të lejojnë një palë të tretë të përshtatshme të ketë akses e të mund të shohë dosjet e kërkuara. Me lirimin e të miturve, të dhënat e tyre gjyqësore do të vulosen, dhe, në një kohë të përshtatshme, do të fshihen.

20. Asnjë i mitur nuk duhet pranuar në një ambient paraburgimi pa një urdhër të vlefshëm të një autoriteti gjyqësor, administrativ apo një autoriteti tjetër publik. Hollësitë e këtij urdhëri duhet të shënohen menjëherë në regjistër. Asnjë i mitur nuk duhet mbajtur në ndonjë mjedis paraburgimi ku nuk ka një regjistër të tillë.

### ***B. Pranimi, regjistrimi, lëvizja dhe transferimi***

21. Në çdo vend ku mbahen të mitur, duhet të mbahen të dhëna të hollësishme, të plota dhe të sigurta të informacionit të mëposhtëm për çdo të mitur të pranuar atje:

(a) Informacion mbi identitetin e të miturit;

(b) Faktin dhe arsyet e angazhimit dhe autoritetin që e ka marrë atë;

(c) Ditën dhe orën e pranimit, transferimit dhe lëshimit;

(d) Hollësi për njoftimin e prindërve apo kujdestarëve për çdo pranim, transferim apo lënie të lirë të të miturit në kujdesin e tyre në kohën e angazhimit;

(e) Hollësi për problemet e njohura fizike dhe mendore, përfshirë abuzimin me drogë apo alkohol.

22. Informacioni për pranimin, vendin, transferimin dhe lënien të lirë u duhet siguruar pa vonesë prindërve dhe kujdestarëve ose njërëzve më të afërt të të miturit në fjalë.

23. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas pritjes, duhet të përgatiten raporte të plota dhe informacioni i duhur për situatën personale dhe rrethanat e çdo të mituri dhe t'i dorëzohen administratës.

24. Në momentin e pranimit, të gjithë të miturve u jepet një kopjo e rregullave të ambienteve të paraburgimit dhe një përkrahje me shkrim i të drejtave dhe detyrimeve të tyre në një gjuhë që ata e kuptojnë, së bashku me adresën e autoriteteve kompetente, të cilave mund t'ju drejtohen ankesat, si dhe adresën e agjencive dhe organizatave publike ose private që japin ndihmë ligjore. Për ata të mitur, që janë analfabetë ose që nuk mund ta kuptojnë gjuhën në formularin e shkruar, informacioni u duhet transmetuar në mënyrë të tillë që të sigurohet se ata e kuptojnë plotësisht atë.

25. Të gjithë të miturit duhen ndihmuar për të kuptuar rregullat që rregullojnë organizimin e brendshëm të mjedisit (të paraburgimit), qëllimet dhe metodologjinë e kujdesit të siguruar, kërkesat dhe proceset disiplinore, metodat e tjera të autorizuara të kërkimit të informacionit dhe të bërjes së ankesave dhe të gjitha çështjet e tjera të nevojshme për të bërë të mundur që ata t'i kuptojnë plotësisht të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë paraburgimit.

26. Transporti i të miturve duhet të bëhet me shpenzimet e administratës me mjete transporti me ventilim dhe dritë të mjaftueshme, në kushte që, në asnjë mënyrë, nuk duhet t'i vendosë ata në vështirësi apo t'i bëjë objekt poshtërimi. Të miturit nuk duhet të transferohen nga një ambient paraburgimit në tjetrin në mënyrë arbitrare.

### ***C. Klasifikimi dhe vendosja***

27. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas momentit të pranimit, çdo i mitur duhet të intervistohet, dhe duhet të përgatitet një raport psikologjik dhe social duke identifikuar çdo faktor që ka lidhje me llojin dhe nivelin specifik të kujdesit dhe programit që kërkohet nga i mituri. Ky raport, së bashku me raportin e përgatitur nga një mjek që ka ekzaminuar të miturin në momentin e pranimit, duhet t'i dërgohet drejtorit me qëllim përcaktimin e vendit më të përshtatshëm për të miturin brenda ambientit të paraburgimit, si dhe llojin dhe nivelin e kujdesit dhe programit të kërkuar për tu ndjekur. Kur kërkohet trajtim i veçantë rehabilitues, dhe kur e lejon koha e qëndrimit në ambientin e paraburgimit, personeli i trajnuar i ambientit të paraburgimit duhet të përgatisë një plan trajtimi me shkrim të individualizuar duke specifikuar objektivat e trajtimit, afatin kohor dhe mjetet, fazat dhe vonesat, me të cilat objektivat duhet të arrihen.

28. Ndalimi i të miturve duhet të ndodhë vetëm në kushte që marrin plotësisht parasysh nevojat e tyre të veçanta, statusin dhe kërkesat speciale sipas moshës së tyre, personalitetit, seksit dhe llojit të veprës kriminale të kryer, ashtu si edhe shëndetin e tyre mendor dhe fizik, dhe që sigurojnë mbrojtjen e tyre nga ndikime të dëmshme dhe situata të rrezikshme. Kriteri kryesor për ndarjen e kategorive të ndryshme të të miturve, të cilëve u është hequr liria, duhet të jetë sigurimi i llojit të kujdesit, që i përshtatet më mirë nevojave të veçanta të individëve në fjalë dhe mbrojtjes së integritetit të tyre fizik, mendor dhe moral si dhe mirëqënies së tyre.

29. Në të gjitha ambientet e paraburgimit, të miturit duhet të veçohen nga të rriturit, përveç rasteve kur ata janë anëtarë të së njëjtës familje. Në kushte të kontrolluara, të miturit mund të vihen bashkë me të rritur të zgjedhur me kujdes si pjesë të një programi të veçantë që ka treguar se i sjell përfitime të miturve në fjalë.

30. Duhet të ngrihen ambiente paraburgimi të hapura për të miturit. Ambientet e hapura të paraburgimit janë pa masa sigurie ose me masa sigurie minimale. Numri i të ndaluarve në këto ambiente paraburgimi duhet të jetë sa më i vogël që të jetë e mundur. Numri i të miturve në ambiente paraburgimi të mbyllura duhet të jetë aq i vogël, sa të mundësojë trajtimin individual. Ambientet e paraburgimit për të mitur duhet të decentralizohen dhe duhet të kenë madhësi të tillë që të lehtësojë aksesin dhe kontaktet mes të miturve dhe familjeve të tyre. Duhet të ngrihen ambiente të vogla paraburgimi e të integrohen në mjedisin social, ekonomik dhe kulturor të komunitetit.

#### ***D. Mjedisi fizik dhe sistemimi***

31. Të miturit, të cilëve u është hequr liria, kanë të drejtën e lehtësirave dhe shërbimeve që plotësojnë të gjitha kërkesat e dinjitetit shëndetësor dhe njërezor.

32. Planvendosja e ambienteve të paraburgimit për të mitur dhe mjedisi fizik duhet të jenë në përputhje me qëllimin rehabilitues të trajtimit rezidencial (të banimit), duke marrë parasysh nevojën e të miturve për jetë private, mundësi për tu shoqëruar më shokë dhe për të marrë pjesë në sporte, ushtrime fizike dhe aktivitete në kohën e lirë. Planvendosja dhe struktura e ambienteve të paraburgimit për të mitur duhet të jetë e tillë që të minimizojë rrezikun e zjarrit dhe të sigurojë evakuim të plotë nga ndërtesa. Duhet të ketë një sistem alarmi eficient në rast zjarri, si dhe procedura zyrtare dhe

stërvitjeje për të garantuar sigurinë e të miturve. Ambientet e paraburgimit nuk duhet të ndodhen në zona, që dihet se paraqesin rreziqe për shëndetin ose rreziqe të tjera.

33. Normalisht, vendet e fjetjes duhet të përbëhen nga fjetina për grupe të vogla ose dhoma individuale, duke pasur parasysh standardet vendase. Gjatë orëve të gjumit, të të gjitha zonat e fjetjes, përfshirë dhomat individuale dhe fjetinat e grupeve/kolektive duhet të mbikqyren sistematikisht, pa shkaktuar bezdi, për të siguruar sigurinë e çdo të mituri. Çdo i mitur, duhet, në përputhje me standardet lokale ose ato në shkallë vendi, të pajiset me krevatin e vet e shtresa të mjaftueshme për të fjetur, të cilat duhet të jenë të pastra kur u jepen, të mbahen mirë dhe të ndërrohen aq shpesh sa duhet për t'i mbajtur të pastra.

34. Instalimet sanitare duhet të vendosen në vende të tilla dhe të jenë të standardeve të mjaftueshme për t'i mundësuar çdo të mituri të përmbushë, siç kërkohet, nevojat e veta fizike në intimitet dhe në një mënyrë të pastër dhe të hijshme.

35. Zotërimi i sendeve personale është një element bazë i të drejtës për intimitet dhe thelbësor për mirëqënien psikologjike të të miturit. E drejta e çdo të mituri për të zotëruar sende personale dhe për të pasur një vend të mjaftueshëm/storage facility për t'i mbajtur ato duhet të njihet dhe respektohet plotësisht. Sendet personale, që i mituri zgjedh të mos i mbajë ose që i janë konfiskuar, duhet të vendosen në vend të sigurtë. Një inventar i tyre duhet të firmoset nga i mituri. Duhet të merren hapa për t'i ruajtur ato në gjendje të mirë. Të gjitha këto sende dhe para duhet t'i kthehen të miturit kur ai lirohet, përveçse kur ai ose ajo ka qënë i/e autorizuar të shpenzojë para ose t'i dërgojë këto sende jashtë ambientit të paraburgimit. Në qoftë se një i mitur merr ose zbulohet se zotëron ndonjë medikament, mjeku duhet të vendosë se çfarë duhet bërë me këtë medikament.

36. Brenda mundësive, të miturit duhet të kenë të drejtë të veshin rrobat e veta. Ambientet e paraburgimit duhet të sigurojnë që çdo i mitur të ketë veshje personale të përshtatshme për klimën dhe të mjaftueshme për të siguruar shëndet të mirë, dhe që në asnjë mënyrë të mos jenë degraduese apo poshtëruese. Të miturit që hiqen ose largohen nga një ambient paraburgimi për çfarëdolloj qëllimi, duhet të lejohen të veshin rrobat e veta.

37. Çdo ambient paraburgimi duhet të garantojë që çdo i mitur të marrë ushqim të përgatitur në mënyrë të përshtatshme dhe të paraqitur në vaktet normale të ushqimit, me atë cilësi dhe sasi që plotëson standardet e dietetikës, higjenës dhe shëndetit, dhe për aq sa është e mundur, kërkesat fetare dhe kulturore. Çdo i mitur duhet të ketë ujë të pijshëm të pastër në çfarëdolloj kohe.

#### ***E. Arsimimi, trajnimi profesional dhe puna***

38. Çdo i mitur në moshën e shkollës së detyrueshme ka të drejtën e arsimimit të përshtatur me nevojat dhe aftësitë e tij ose të saj dhe të planifikuar në mënyrë të tillë që ta përgatisë atë për t'u kthyer në shoqëri. Ky arsimim duhet siguruar jashtë ambienteve të paraburgimit, në shkollat e komunitetit, kudo që të jetë e mundur dhe në çdo rast, nga mësues të kualifikuar përmes programeve të integruara në sistemin arsimor të vendit, në mënyrë që pas daljes në liri, të miturit të mund të vazhdojnë arsimimin e tyre pa vështirësi. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar nga

administrata e ambienteve të paraburgimit arsimimit të të miturve me origjinë të huaj ose me nevosa të veçanta kulturore ose etnike. Të miturit që janë analfabetë ose që kanë vështirësi cognitive/njohëse apo vështirësi në të mësuar duhet të kenë të drejtën e një arsimimi të veçantë.

39. Të miturit mbi moshën e shkollës së detyrueshme, që dëshirojnë të vazhdojnë arsimimin e tyre duhet të lejohen e të inkurajohen që të veprojnë kështu, dhe duhet bërë çdo përpjekje për tu dhënë atyre mundësi për të ndjekur programe të përshtatshme arsimore.

40. Diplomat apo çertifikatat arsimore (dëftesat shkollore) që i jepen të miturve gjatë kohës që ata janë në paraburgim nuk duhet të përmendin/tregojnë në asnjë lloj mënyre se i mituri ka qënë i institucionalizuar.

41. Çdo ambient paraburgimi duhet të sigurojë mundësi hyrjeje/akses në një bibliotekë të pajisur mjaftueshëm si me libra udhëzues ashtu edhe rikrijues të përshtatshëm për të mitur, që duhen inkurajuar dhe mundësuar që t'i përdorin plotësisht ato.

42. Çdo i mitur duhet të ketë të drejtën e trajnimit profesional në profesione/zanate që kanë mundësi ta përgatisin atë për punësim të ardhshëm.

43. Përsa i përket përzgjedhjes së duhur profesionale dhe kërkesave për administrim institucional, të miturit duhet të jenë në gjendje të zgjedhin llojin e punës që ata dëshirojnë të kryejnë.

44. Të gjithë standardet mbrojtëse kombëtare dhe ndërkombëtare të zbatueshme për punën e fëmijëve dhe punëtorëve të rinj në moshë duhet të zbatohen për të miturit, të cilëve u është hequr liria.

45. Kudo që është e mundur, të miturve u duhet dhënë mundësia që të punojnë me pagesë, nëse është e mundur brenda komunitetit vendas, si një plotësim për trajnimin profesional që u sigurohet, me qëllim që të rritet mundësia që të gjejnë punësim të përshtatshëm kur të kthehen në komunitetet e tyre. Lloji i punës duhet të jetë i tillë që tu sigurojë trajnimin e duhur, nga i cili të miturit të përfitojnë kur të lirohen. Organizimi dhe metodat e punës të ofruara në ambientet e paraburgimit duhet të ngjajnë sa më shumë që të jetë e mundur me punën e ngjashme në komunitet, në mënyrë që të miturit të përgatiten për kushtet e jetës normale të punës.

46. Çdo i mitur që bën një punë duhet të ketë të drejtën e një shpërbimi/pagese të drejtë. Interesat e të miturve dhe ato të trajnimit të tyre profesional nuk duhet t'i shërbejnë qëllimit të përfitimit për ambientet e paraburgimit apo për një palë të tretë. Normalisht, një pjesë e fitimeve të të miturit duhet të vihet mënjanë si fond kursimesh për t'iu dorëzuar të miturit kur të lirohet. I mituri duhet të ketë të drejtë ta përdorë pjesën tjetër të këtyre fitimeve për të blerë sende për përdorim vetjak ose për të zhdëmtuar viktimën e dëmtuar nga vepra e tij kriminale ose për t'ia dërguar familjes së tij/saj ose personave të tjerë jashtë ambienteve të paraburgimit.

## **F. Veprimtari zbavitëse**

47. Çdo i mitur ka të drejtën e një sasi të përshtatshme kohe për ushtrime të lira të përditshme në mjedis të hapur, kurdo që e lejon moti, gjatë së cilës duhet siguruar normalisht trajnim i përshtatshëm zbavitës dhe fizik. Për këto veprimtari, duhet të sigurohen hapësirë, instalime dhe pajisje të mjaftueshme. Çdo i mitur duhet të ketë kohë shtesë për veprimtari të përditshme të kohës së lirë, pjesë e së cilës i duhet kushtuar, nëse i mituri e dëshiron një gjë të tillë, zhvillimit të arteve dhe mjeshtërive të punëve të dorës. Mjediset e parburgimit duhet të sigurojnë se çdo i mitur është fizikisht në gjendje të marrë pjesë në programet e disponueshme të edukimit fizik. Edukimi fizik kurues dhe terapia duhen ofruar nën mbikqyrje mjekësore për të miturit që kanë nevojë.

## **G. Feja**

Çdo i mitur duhet të lejohet të përmbushë nevojat e jetës së vet fetare dhe shpirtërore, në veçanti duke ndjekur shërbesat apo takimet e siguruar në mjediset ku mbahet i ndaluar ose duke kryer vetë shërbesat fetare, si dhe të zotërojë librat e nevojshëm ose artikuj në lidhje me praktikimin e riteve fetare dhe udhëzimet për përkatësinë fetare të tij. Nëse një mjedis parburgimi ka një numër të mjaftueshëm të miturish të një feje të caktuar, një ose më shumë përfaqësues të asaj feje duhet të caktohen ose miratohen dhe të lejohen të kryejnë shërbesa rregullisht, si dhe të kushtojnë vizita pastorale vetëm për vetëm me të miturit me kërkesë të tyre. Çdo i mitur duhet të ketë të drejtën të presë vizita nga një përfaqësues i kualifikuar i një feje sipas zgjedhjes së tij, si dhe të drejtën të mos marrë pjesë në shërbesa fetare dhe të heqë dorë lirisht nga edukimi, këshillimi, apo indoktrinimi fetar.

## **H. Kujdesi shëndetësor**

49. Çdo i mitur duhet të marrë kujdes të mjaftueshëm shëndetësor, si parandalues ashtu edhe kurues, duke përfshirë, kujdes shëndetësor dentar, kujdes oftalmologjik të syve, mendor, si dhe produkte farmaceutike dhe dieta speciale sipas përshkrimit të mjekut. I gjithë ky kujdes shëndetësor, ku është e mundur, duhet t'u sigurohet të miturve nëpërmjet mjediseve dhe shërbimeve të përshtatshme shëndetësore të komunitetit në të cilin ndodhet qendra, ku mbahen të ndaluar, me qëllim parandalimin e stigmatizimit të të miturve dhe promovimin e respektit për veten si dhe integrimin në komunitet.

50. Çdo i mitur ka të drejtën të ekzaminohet nga një mjek menjëherë me pranimin e tij në mjediset ku mbahen të ndaluar, me qëllim regjistrimin e ndonjë të dhëne për keqtrajtim të mëparshëm dhe identifikimin e ndonjë gjendjeje fizike ose mendore që kërkon vëmendje mjekësore.

51. Shërbimet mjekësore të siguruar për të miturit duhet të kërkojnë të zbulojnë dhe duhet të trajtojnë çdo sëmundje fizike apo mendore, abuzim me substanca apo ndonjë gjendje tjetër, që mund të pengojë integrimin e të miturit në shoqëri. Çdo mjedis, ku mbahen të ndaluar të mitur, duhet të ketë akses të menjëhershëm në mjediset dhe pajisje mjekësore të mjaftueshme në përputhje me numrin dhe kërkesat e banuesve si dhe personel të trajnuar në kujdesin shëndetësor parandalues dhe trajtimin e urgjencave mjekësore. Çdo i mitur, që është i sëmurë, që ankohet për sëmundje, ose



që shfaq simptoma të vështirësive fizike apo mendore, duhet të ekzaminohet në kohë nga një mjek.

52. Çdo mjek që ka arsye të besojë se shëndeti fizik apo mendor i një të mituri është ose do të dëmtohet nga heqja e vazhdueshme e lirisë, një grevë urie, apo çfarëdo gjendje e heqjes së lirisë duhet ta raportojë këtë fakt menjëherë tek drejtori i mjedisit të paraburgimit në fjalë dhe autoritetit të pavarur përgjegjës për sigurinë dhe mirëqënien e të miturve.

53. I mituri që vuan nga një sëmundje mendore, duhet të trajtohet në një institucion të specializuar nën drejtim të pavarur mjekësor. Në marrëveshje me agjencitë e duhura, duhen ndërmarrë hapa për të siguruar çdo vazhdimësi të kujdesit për shëndetin mendor pas daljes.

54. Qendrat, ku mbahen të ndaluar të miturit, duhet të kenë programe të specializuara të parandalimit dhe rehabilitimit për abuzimin me drogat, të administruara nga një personel i kualifikuar. Këto programe duhet të përshtaten sipas moshës, seksit dhe kërkesave të tjera të të miturve në fjalë, si dhe duhet të jenë të disponueshme mjedise dhe shërbime detoksikimi me personel të kualifikuar për të mitur me varësi ndaj drogës ose alkoolit.

55. Medikamentet duhet të administrohen vetëm për trajtim të domosdoshëm për arsye mjekësore dhe, kur është e mundur, pasi të jetë marrë miratimi i informuar i të miturit në fjalë. Në veçanti, ato nuk duhen administruar me qëllim nxjerrjen e informacionit apo rrëfimin si ndëshkim apo si mjet shtrëngimi. Të miturit në asnjë rast nuk do të jenë object testimi në përdorime dhe trajtime eksperimentale të medikamenteve. Administrimi i çdo medikamenti duhet të jetë gjithmonë i autorizuar dhe i zbatuar nga një personel mjekësor i kualifikuar.

### ***1. Njoftimi për sëmundje, dëmtim, dhe vdekje***

56. Familja ose kujdestari i një të mituri, si dhe ndonjë person tjetër i përcaktuar nga i mituri, kanë të drejtën të informohen mbi gjendjen e shëndetit të të miturit me kërkesën e tij dhe në rast ndryshimesh të rëndësishme të shëndetit të të miturit. Drejtori i qendrës ku mbahen të ndaluar të mitur duhet të njoftojë menjëherë familjen ose kujdestarin e të miturit në fjalë, ose ndonjë person tjetër të përcaktuar në rast të vdekjes, sëmundjes, që kërkon transferim të të miturit në një mjedis mjekësor të jashtëm, ose të një gjendjeje që kërkon kujdes klinik brenda mjedisëve ku mbahet i ndaluar për më shumë se 48 orë. Gjithashtu, duhen njoftuar autoritetet konsullore të Shtetit, shtetas i të cilit është i mituri i huaj.

57. Me vdekjen e një të mituri gjatë periudhës së heqjes së lirisë, familjari më i afërt duhet të ketë të drejtën të inspektojë certifikatën e vdekjes, të shohë trupin dhe të përcaktojë mënyrën e trajtimit dhe sistemimit të kufomës. Me vdekjen e një të mituri në heqje lirie, duhet të ketë një hetim të pavarur në lidhje me shkaqet e vdekjes, raporti i të cilit duhet të bëhet i disponueshëm për të afërmin/familjarin më të afërt. Ky hetim duhet të bëhet gjithashtu kur vdekja e një të mituri ndodh brenda gjashtë muajve nga data e lirimimit të tij nga mjediset ku mbahej i ndaluar dhe ka arsye të besohet se vdekja lidhet me periudhën e heqjes së lirisë.

58. Një i mitur duhet të informohet sa më herët të jetë e mundur mbi vdekjen, ose sëmundje serioze ose dëmtim të ndonjë anëtarit të afërt të familjes dhe i duhet siguruar mundësia që ndjekë varrimin e të ndjerit ose të vizitojë një të afërm të sëmurë në gjendje kritike.

#### **J. Kontakte me një komunitet më të gjerë**

59. Duhet siguruar çdo mënyrë e mjet për të siguruar komunikim të mjaftueshëm të të miturit me botën e jashtme, që është pjesë integrale e të drejtës për trajtim të drejtë dhe human dhe është thelbësore në përgatitjen e të miturve për rikthimin e tyre në shoqëri. Të miturit duhet të lejohen të komunikojnë me familjen, miqtë e tyre dhe persona të tjerë ose përfaqësues të organizatave të tjera të jashtme me emër/reputacion të mirë, të lënë mjediset e kryerjes së dënimit për një vizitë pranë shtëpisë dhe familjes dhe të marrin leje të lënë vendin ku mbahen të ndaluar për arsimim, formim profesional ose arsye të tjera të rëndësishme. Në rast të kryerjes së dënimit nga ana e të miturit, koha e kaluar jashtë mjedisit ku mbahet i ndaluar duhet të llogaritet si periudhë e dënimit.

60. Çdo i mitur duhet të ketë të drejtën të presë vizita sistematike dhe të shpeshta, në parim një herë në javë dhe jo më pak se njëherë në muaj, në rrethana që respektojnë nevojën e të miturit për intimitet, kontakt dhe komunikim të pakufizuar me familjen dhe avokatin mbrojtës.

61. Çdo i mitur duhet të ketë të drejtën të komunikojë me shkrim ose me telefon të paktën dy herë në javë me një person sipas zgjedhjes së tij, përveçse kur është i kufizuar ligjërisht, dhe duhet të asistohet sipas nevojës me qëllim që të gëzojë të drejtën e tij në mënyrë të efektshme. Çdo i mitur duhet të ketë të drejtën për letërkëmbim.

62. Të miturit duhet të kenë mundësinë të informohen rregullisht në lidhje me të rejtat duke lexuar gazetatat, botimet periodike dhe botime të tjera, me anë të aksesit në programe radio-televizive dhe filmave, dhe nëpërmjet vizitave të përfaqësuesve të klubeve të ndryshme dhe organizatave të ligjshme në të cilat i mituri është i interesuar.

#### **K. Kufizime të shtrëngimit fizik dhe përdorimi i forcës**

63. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit dhe detyrimit për çfarëdo qëllimi duhet të ndalohet përveçse në rastet e parashikuara nga rregulli 64 më poshtë.

64. Instrumentet e shtrëngimit dhe detyrimit mund të përdoren vetëm në raste përjashtimore/të jashtëzakonshme, ku të gjitha metodat e tjera të kontrollit janë përdorur dhe kanë dështuar, dhe vetëm sipas autorizimit të qartë dhe specifik nga ligji dhe rregullorja. Ato nuk duhet të shkaktojnë poshtërim apo degradim, duhen përdorur në mënyrë të kufizuar dhe vetëm për periudhën më të shkurtër të mundshme kohore. Me urdhër të drejtorit të administratës, instrumente të tilla mund të përdoren me qëllim që të mos lejojnë të miturin t'i shkaktojë ndonjë dëmtim vetes, të tjerëve apo shkatërrime serioze të pronës. Në raste të tilla, drejtori duhet të konsultohet menjëherë me personelin mjekësor dhe personelin tjetër përkatës dhe t'i raportojë autoritetit administrativ më lartë.

65. Mbajtja dhe përdorimi i armëve nga personeli duhet ndaluar në çdo mjedis, ku mbahen të ndaluar të mitur.

### ***L. Proceset disiplinore***

66. Çdo masë dhe procedurë disiplinore duhet të ruajë interesin e sigurisë dhe të një jete komunitare të rregullt dhe duhet të jetë në përputhje me ruajtjen e një dinjiteti të brendshëm të të miturit dhe objektivin themeltar të kujdesit institucional, më konkretisht, mbjelljen e një sensi drejtësie, respekti për veten dhe respektin për të drejtat bazë për çdo person.

67. Të gjitha masat disiplinore që përmbajnë trajtim mizor, çnjerëzor, apo degradues duhet të ndalohen rreptësisht, duke përfshirë ndëshkimin fizik, vendosjen në një qeli të errët, kufizimin me mbyllje ose në vetmi, apo ndonjë ndëshkim që mund të kompromentojë shëndetin fizik apo mendor të të miturit në fjalë. Reduktimi i dietës dhe kufizimi ose mohimi i kontaktit me pjesëtarë të familjes duhet të ndalohet për çfarëdolloj qëllimi. Puna duhet të shihet gjithmonë si mjet edukimi dhe promovimi i respektit për veten nga ana e të miturit në përgatitjen e tij për rikthim në komunitet dhe nuk duhet të imponohet si një masë disiplinore. Ndaj asnjë të mituri nuk duhet marrë masa më shumë se një herë për të njëjtën shkelje disiplinore. Masat kolektive duhen ndaluar.

68. Legjislacioni dhe rregulloret e miratuara nga autoriteti administrativ kompetent duhet të përcaktojnë norma në lidhje me sa më poshtë duke marrë parasysh plotësisht karakteristikat, nevojat, dhe të drejtat themelore të të miturve:

- (a) Sjelljet që përbëjnë shkeljeje disiplinore;
- (b) Llojin dhe kohëzgjatjen e masave disiplinore që mund të merren;
- (c) Autoritetin kompetent për marrjen e masave të tilla;
- (d) Autoritetin kompetent për të shqyrtuar apelimet.

69. Raporti për sjellje të keqe duhet paraqitur në kohë para autoritetit kompetent, që duhet të vendosë pa vonesë të panevjoshme. Autoriteti kompetent duhet të bëjë një shqyrtim të imtësishëm të rastit.

70. Asnjë i mitur nuk duhet t'i nënshtrohet një sanksioni/masë disiplinore përveçse në përputhje të rreptë me parashikimet e ligjit dhe rregullave në fuqi. Asnjë i mitur nuk duhet t'i nënshtrohet sanksionit përveçse kur është informuar për shkeljen e pretenduar në mënyrën e duhur dhe është kuptuar në mënyrë të plotë nga ana e të miturit dhe i është dhënë mundësia e duhur për të paraqitur mbrojtjen e tij, duke përfshirë edhe të drejtën e apelimet pranë një autoriteti të paanshëm kompetent. Për të gjitha proceset disiplinore duhen mbajtur të dhëna të plota.

71. Asnjë i mitur nuk duhet të jetë përgjegjës për funksione disiplinore përveç rasteve të mbikqyrjes së veprimtarive të specifikuara sociale, edukative, apo sportive ose në programet vetjake.

### ***M. Inspektimi i ankimimeve***

72. Inspektorë të kualifikuar ose një autoritet i barazvlefshëm i vendosur sipas rregullave/i autorizuar zyrtarisht, që nuk janë të administratës së mjediseve ku mbahen të ndaluar të miturit, duhet të fuqizohen/t'u jepet pushtet për të inspektuar rregullisht dhe për të ndërmarrë inspektime të palajmëruara me nismën e tyre, dhe duhet të gëzojnë garanci të plotë pavarësie në ushtrimin e këtij funksioni. Inspektorët duhet të kenë akses të pakufizuar tek të gjithë personat e punësuar nga një institucion paraburgimi ose personat që punojnë në mjedise paraburgimi, ku të miturve u është hequr ose mund t'u hiqet liria, tek të gjithë të miturit, si dhe të gjitha të dhënat në regjistrat e këtyre mjediseve.

73. Në inspektime duhet të marrin pjesë zyrtarë të kualifikuar të mjekësisë atashuar pranë autoritetit inspektues ose shërbimit shëndetësor, duke vlerësuar përputhshmërinë me rregullat që kanë të bëjnë me mjedisin fizik, higjenën, strehimin, ushqimin, ushtrimet dhe shërbimet mjekësore, si dhe aspekte apo kushte të tjera të jetës institucionale, që ndikojnë mbi shëndetin mendor dhe fizik të të miturve. Çdo i mitur duhet të ketë të drejtën të flasë në konfidencë me çdo zyrtar inspektimi.

74. Pas përfundimit të inspektimit, inspektorit duhet t'i kërkohet të paraqesë një raport mbi konstatimet. Raporti duhet të përfshijë përputhshmërinë e mjediseve ku mbahen të ndaluar të miturit me rregullat aktuale dhe dispozitat përkatëse të ligjit vendas si dhe rekomandime në lidhje me hapat e konsideruara të nevojshme për të siguruar përputhshmëri me to. Çdo fakt i zbuluar nga inspektorët që duket të tregojë se ka ndodhur një shkelje dispozitave ligjore për sa u përket të drejtave të të miturve apo operimit të një mjedisi ku mbahen të ndaluar të miturit duhet t'i komunikohet autoriteteve kompetente për hetim dhe ndjekje.

75. Çdo i mitur duhet të ketë mundësinë të bëjë kërkesa apo ankime tek drejtori i mjediseve ku mbahen të ndaluar të miturit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.

76. Çdo i mitur duhet të ketë të drejtën të bëjë kërkesa apo ankime, pa censurim në përmbajtje, administratës qendrore, autoriteteve gjyqësore apo autoriteteve të tjera të përshtatshme nëpërmjet rrugëve të miratuara, dhe të informohet për përgjigjen pa vonesë.

77. Përpyekje duhen bërë për krijimin e një zyre të pavarur (ombudsman) për të marrë dhe hetuar ankesa të bëra nga të mitur të privuar nga liria dhe për të ndihmuar në arritjen e zgjidhjeve të drejta.

78. Çdo i mitur duhet të ketë të drejtë të kërkojë asistencë nga pjesëtarë të familjes, këshilltar ligjor, grupe humanitare apo të tjerë ku është e mundur, me qëllim paraqitjen e një ankese. Të miturve analfabetë duhet t'u sigurohet asistencë në rast se u nevojitet të përdorin shërbime të agjencive publike ose private dhe organizatave që sigurojnë këshillim ligjor apo janë kompetente në pritjen e ankesave.

#### ***N. Rikthimi në komunitet***

79. Të gjithë të miturit duhet të përfitojnë nga rregullimet e përcaktuara për t'i ndihmuar në kthimin e tyre në shoqëri, jetën familjare, arsimim apo punësim pas lirit. Për këtë qëllim duhen hartuar procedura, përfshirë lirim të hershëm, dhe kurse të veçanta.

80. Autoritetet kompetente duhet të ofrojnë ose sigurojnë shërbime me qëllim asistimin e të miturve në rivendosjen e tyre në shoqëri dhe të pakësojë paragjykimin ndaj këtyre të miturve. Këto shërbime duhet të sigurojnë, në shkallën e mundshme, që i mituri të pajiset me banesë të përshtatshme, punësim, veshje dhe mjete të mjaftueshme për të mbajtur veten pas lirit me qëllim lehtësimin e ri-integrimit të suksesshëm. Përfaqësues të agjencive që sigurojnë këto shërbime duhet të konsultohen dhe duhet të kenë akses tek të miturit gjatë kohës që janë të ndaluar, me qëllim ndihmesën për kthimin e tyre në komunitet.

#### ***V. Personeli***

81. Personeli duhet të jetë i kualifikuar dhe të përfshijë numër të mjaftueshëm specialistësh të tillë si edukatorë, instruktorë të profesioneve të ndryshme, këshilltarë, punonjës socialë, psikiatër dhe psikologë. Këta dhe personeli tjetër i specialistëve duhet të punësohen normalisht në mënyrë të përhershme. Kjo nuk duhet të përjashtojë punonjës me kohë të pjesshme apo vullnetarë kur niveli i mbështetjes dhe i trajnimit që ata sigurojnë është i përshtatshëm dhe përfitues. Mjediset e ndalimit të të miturve duhet të shfrytëzojnë burime ndreqëse edukative, morale, frymërore, e të tjera si dhe forma të asistencës që janë të përshtatshme dhe të disponueshme në komunitet, sipas nevojave të individëve dhe problemeve të të miturve të ndaluar.

82. Administrata duhet të sigurojë përzgjedhje dhe rekrutim të kujdesshëm të çdo grade dhe tipi të personelit, duke qenë se manaxhimi i duhur i mjediseve të ndalimit varet nga integriteti, humanizmi, aftësia dhe kapaciteti profesional i tyre për t'u marrë me të miturit si dhe përshtatshmëria personale për punën.

83. Për të garantuar qëllimet e sipërpërmenduar, personeli duhet të emërohet në cilësinë e zyrtarëve profesionalë me pagesë të mjaftueshme për të tërhequr dhe mbajtur burra e gra të përshtatshëm. Personeli i mjediseve ku mbahen të ndaluar të miturit duhet inkurajuar vazhdimisht që të përmbushë detyrimet dhe detyrat në mënyrë humane, të përkushtuar, profesionale, të drejtë dhe të efektshme, të sillen gjatë gjithë kohës në mënyrë të tillë që të meritojnë dhe fitojnë respektin e të miturve dhe t'u japin të miturve një model dhe perspektive pozitive.

84. Administrata duhet të fusë forma organizimi dhe manaxhimi që lehtësojnë komunikimin midis kategorive të ndryshme të personelit në çdo mjedis paraburgimi me qëllim rritjen e bashkëpunimit midis shërbimeve të ndryshme të përfshira në kujdesin për të miturit si dhe midis personelit dhe administratës me qëllim që të sigurohet se personeli në kontakt të drejtpërdrejtë me të miturit janë në gjendje të funksionojnë në kushte të favorshme për përmbushjen e efektshme të detyrave të tyre.

85. Personeli duhet të marrë trajnim të tillë që do t'i mundësojë përmbushjen e përgjegjësisë me efikasitet, në veçanti trajnim mbi psikologjinë e fëmijëve,

mirëqënien e fëmijëve dhe standardet dhe normat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë dhe Rregulloren aktuale. Personeli duhet të ruajë dhe përmirësojë njohurinë dhe kapacitetin profesional duke ndjekur kurse trajnimi gjatë punës, që duhen organizuar në intervale të përshtatshme përgjatë karrierës së tyre.

86. Drejtori i mjediseve duhet të ketë kualifikimin e mjaftueshëm për detyrën e tij, me aftësi administrative dhe trajnim të përvojë të përshtatshme dhe duhet të kryejë detyrat e tij me kohë të plotë.

87. Në kryerjen e detyrave, personeli i mjediseve ku mbahen të ndaluar të miturit duhet të respektojë dhe mbrojë dinjitetin njerëzor dhe të drejtat themelore të njeriut të të gjithë të miturve, në veçanti, në lidhje me sa më poshtë:

(a) Asnjë pjesëtar i personelit të një mjedisi apo institucioni nuk mund të vendosë, shkaktojë apo tolerojë asnjë formë torture apo ndonjë formë tjetër trajtimi, ndëshkimi, ndreqjeje apo disiplinimi të ashpër, mizor, çnjerëzor apo degradues për asnjë pretekst apo rrethanë;

(b) I gjithë personeli duhet rigorozisht të kundërshtojë dhe luftojë çdo vepër korrupsioni, duke e raportuar pa vonesë tek autoritetet kompetente;

(c) I gjithë personeli duhet të respektojë Rregullat aktuale. Personeli që ka arsye të besojë se ka ndodhur ose do të ndodhë një shkelje serioze e Rregullores aktuale duhet ta raportojë çështjen autoriteteve eprorë ose organeve të veshura me pushtet rishikues apo zgjidhës;

(d) I gjithë personeli duhet të sigurojë mbrojtje të plotë të të drejtës së të miturve për *privacy* dhe, në veçanti, duhet të mbrojë të gjitha çështjet konfidenciale që kanë të bëjnë me të miturin apo familjen e tyre të mësuara për shkak të profesionit;

(e) I gjithë personeli duhet të respektojë të drejtën e të miturve për *privacy*, dhe, në mënyrë të veçantë, duhet të ruajë të gjitha çështjet konfidenciale që kanë lidhje me të miturit apo me familjet e tyre, që I ka mësuar si rrjedhojë e kapacitetit të tij profesional;

(f) I gjithë personeli duhet të kërkojë minimizimin e dallimeve midis jetës brenda dhe asaj jashtë mjedisit kur mbahen të ndaluar, që priren të zvogëlohen për rrjedhojë të respektit për dinjitetin e të miturve si qenie njerëzore.